

KËRKESË
Nr. 2497/4, datë 21.7.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Rrjeti shpërndarës 20 kV, nënstacioni Pogradec fideri 1, 9, 10, rikonstruksion kabina, kabina të reja dhe linjë TU me përcjellësa me vetëmbajtje ABC”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 4 999.68 (katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT “RRJETI SHPËRNDARËS 20 kV, NËNSTACIONI POGRADEDEC FIDERI 1, 9, 10, RIKONSTRUKSION KABINA, KABINA TË REJA DHE LINJË TU ME PËRCJELLËS ME VETËMBAJTJE ABC”

Nr.	Numri i kabinës	Emër	Atësia	Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale (m²)	Sip. e prekur (m²)	Çmimi truall lekë/m²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	14	15
POGRADEDEC, VENDORE ZONA KADASTRALE 3745												
1	1/8 Kalceto	Luan Selviko Edison	Feti Selman Luan	Musollari Musollari Musollari	arë	3745	29/1/31	2000	26.04	192	4999.68	Konfirmuar nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Pogradec Bashkëpronësi
VLERA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT											4999.68	

Për tokën “arë”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.